



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PEJË - DEGA E GJYKATËS ISTOG

Numri i lëndës: 2023:079815

Datë: 28.02.2025

Numri i dokumentit: 06917599

C.nr.442/23

GJYKATA THEMELORE NË PEJË- DEGA ISTOG, Departamenti i Përgjithshëm - Divizioni Civil, me gjyqtaren Lirika Sylaj, në çështjen juridike kontestimore të paditësit F. S nga fshati C, Komuna e Istogut, të cilin sipas autorizimit e përfaqëson Merita Binakaj – avokate në Deçan, kundër të paditurës Komuna e Istogut - Drejtoria Komunale e Arsimit, baza e kontestit: kompensim i shpenzimeve të ushqimit – shujtave ditore dhe shpenzimet e udhëtimit, jashtë seance gjyqësore me datë 28.02.2025, merr këtë:

A K T G J Y K I M

- Për shkak të pa dëgjueshmërisë / mosbindjes -

I.APROVOHET në tërësi si e bazuar kërkesëpadia e paditësit F. S, ashtu që: DETYROHET e paditura Komuna e Istogut - Drejtoria Komunale e Arsimit, që paditësit ti kompensojë shumat, në emër të kompensimit për ushqim gjatë punës - shujtave ditore për 210 ditë nga 2(dy) euro për secilën ditë të prezencës në punë, duke e llogaritur prej datës 25.06.2021 deri me datën 22.11.2022, shumën prej 420 euro, në emër të shpenzimeve të udhëtimit për 210 ditë, për 70% të këtyre shpenzimeve në shumën prej 294 euro, e të gjitha këto në shumën e përgjithshme prej 714.00 Euro, me kamatë ligjore 8% në vit, nga data 23.03.2023, e deri në pagesën definitive të detyrimit, të gjitha këto në afat prej 7 ditësh nga dita e pranimit të këtij aktgjykimi, nën kërcënim të përmbarrimit të detyrueshëm.

II.DETYROHET e paditura Komuna e Istogut - Drejtoria Komunale e Arsimit, t’ia paguaj paditësit shpenzimet e procedurale në shumë të përgjithshme prej 125 Euro, në afat prej 7 ditësh nga dita e pranimit të këtij aktgjykimit, nën kërcënim të përmbarrimit të detyrueshëm.

A r s y e t i m

Paditësit, përmes të autorizuarës se tij kanë parashtruar në këtë gjykatë padi me datë 23.03.2023, të precizuar me vone me parashtrësën e datës 29.01.2025, kundër të paditurës Komuna e Istogut- Drejtoria Komunale e Arsimit, sipas bazës juridike kompensim i shpenzimeve të ushqimit-shujtave ditore si dhe kompensimi i shpenzimeve të udhëtimit.

Gjykata në këtë çështje juridike kontestimore pas shqyrtimit paraprak të padisë ka nxjerrë aktvendimin për përgjigje në padi me datë, të cilin e paditura e ka pranuar me datë 28.03.2024 (kjo e konfirmuar përmes fletë kthesës, e cila gjendet në shkresat e lëndës). Me aktvendimin për përgjigje në padi, gjykata e ka njoftuar të paditurën për detyrimin ligjor për dhënie të përgjegjës në padi dhe për pasojat ligjore që do t'i ketë nëse nuk paraqet përgjigje në padi, gjegjësisht për mundësinë që gjykata të marrë aktgjykim për shkak të mosbindjes - pa dëgjueshmërisë.

E paditura, pavarësisht se e ka pranuar aktvendimin për përgjigje në padi, së bashku me padinë dhe provat materiale si dhe parashtresën mbi precizimin e kërkesëpadisë [të pranuar me datën 31.01.2025] në këtë çështje juridike kontestuese, nuk ka paraqitur përgjigje në padi brenda afatit ligjor.

Gjykata, pasi i ka vlerësuar kushtet ligjore për nxjerrjen e aktgjykimit për shkak të mosbindjes, ka gjetur së në rastin konkret plotësohen të gjitha kushtet ligjore për nxjerrjen e aktgjykimit në fjalë nga neni 150 paragrafi 1 pikat a), b) dhe (c) të LPK-së, nëse të paditurit i është dorëzuar padia dhe thirrja për përgjigje në padi, se themelësia e kërkesëpadisë del nga faktet e treguara në padi dhe se faktet në të cilat mbështetet kërkesëpadia nuk janë në kundërshtim me provat që i ka propozuar vetë paditësi apo me faktet e ditura botërisht.

Gjykata vërtetoi se themelësia e kërkesëpadisë për paditësit F. S del nga provat të cilat gjenden në shkresat e lëndës, konkretisht nga kontrata me nr. Protokollit 05 nr. 3.../20 e datës 01.10.2020, e lidhur në mes të paditësit dhe këtu të paditurës nga e cila vërtetohet se paditësi është në marrëdhënie pune te e paditura si mësimdhënëse e lëndës së elektronikës në sh.f.m.u "Mithat Frashëri" në G, vërtetimi me numër të protokollit 69../1 i datës 24.01.2025 i lëshuar nga sh.f.m.u "Mithat Frashëri" në G nga e cila vërtetohen ditët e vijueshmërisë në punë nga paditësi për periudhën 25.06.2021 deri me datë 22.11.2022 gjithsej 210 ditë pune, vërtetimi me i lëshuar nga N.T.T "T. S" nga e cila vërtetohet çmimi kushtues të biletës së trafikut për relacionin që e bënë paditësit C - G dhe anasjelltas.

Gjykata gjen se në rastin në fjalë duhet të zbatohet Kontrata Kolektive e Arsimit në Kosovë (KKAK), e nënshkruar në mes të Ministrisë së Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë dhe Sindikatës së Bashkuar të Arsimit, Shkencës dhe Kulturës, e të vitit 2021 (e aplikueshme nga data 22.01.2021-21.11.2022), ku në nenin 35 paragrafi 5 në të cilin përcaktohet se "punonjësve arsimor që udhëtojnë në vendbanimet e komunës përkatëse ku punojnë u paguhen shpenzimet e 70% të biletave të trafikut urban", tutje neni 7 "Të punësuarve (anëtarë të SBASHK-ut), u sigurohet kompensim për ushqim gjatë punës për ditët e pranisë në punë. Vlera e kompensimit të shpenzimit të ushqimit në punë, për një ditë pune për një ditë pune, është dy euro për të punësuarit që kanë marrëdhënien e punës primare në institucionet arsimore. Punëdhënësi i cili ka rregulluar ushqimin e të punësuarve, përmes restorantit, kuzhinës apo ndonjë forme tjetër nuk ka obligim pagese të punësuarve në ushqim", ashtu që gjykata erdhi në përfundim se në rastin konkret paditësit i takon e drejta e kompensimeve si më lartë, të përshkruara, si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, pasi që këto dispozita janë të karakterit imperativ.

Për kamatën gjykata ka vendosur duke u mbështetur në dispozitën e nenit 382 të LMD-së dhe Mendimit Juridike të Gjykatës Supreme të Kosovës për nr.265/2020 të datës 01.12.2020, ka marr datën e ushtrimit të padisë, e ku lartësia e kamatës vjetor është e definuar 8% deri në pagesën definitive.

Vendimin që pala e paditur ti bartë shpenzimet e procedurës, gjykata e ka mbështetur në dispozitat e nenit 449 dhe 452 të LPK-së, ndërsa sa i përket lartësisë së shpenzimeve të procedurës u bazua në nr. tarifor 6 të Rregullores për Tarifën e Avokatëve të Kosovës ashtu që lartësia e shpenzimeve të aprovuara i referohet 104 për përpilim të padisë dhe 21 euro për pagesën e taksës gjyqësore.

Gjykata, vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi duke i'u referuar dispozitës së nenit 150 par.1 pika a, b, dhe c të LPK-së, e në lidhje më dispozitat e nenit 35 paragrafi 5 dhe 7, të Kontratës Kolektive të Arsimit të datës 18.04.2017 dhe 22.01.2021, dhe dispozitave të nenit 245 par.1 dhe 2, neni 249 par.1 dhe 2 të LMD-së.

GJYKATA THEMELORE NË PEJË - DEGA ISTOG,
Departamenti i Përgjithshëm - Divizioni për Çështje Civile

Gj y q t a r j a
Lirika Sylaj

KËSHILLË JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi, në kuptim të dispozitës nga neni 477 të LPK-së është e lejuar ankesa, në afat prej 7 (shtatë) ditësh nga dita e pranimit. Ankesa i drejtohet Gjykatës së Apelit të Kosovës, përmes kësaj gjykate.